



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRIË



LETËR POZICIONI

**FORCIMI I SEKTORIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË
SHQIPËRI NËPËRMJET INVESTIMEVE,
MBËSHTETJES SË POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
BURIMEVE NJERËZORE**



SHTATOR 2025

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1 Hyrje: Qëllimi i Letrës së Pozicionit	5
1.1 Konteksti i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Ujërave të Ndotura në Shqipëri	5
1.2 Roli i SHUKALB në këtë sektor dhe qëllimi i dokumentit.....	8
1.3 Nevoja për një pozicionim të strukturuar mbi sfidat dhe mundësitë e sektorit.....	9
2 Përmbledhje e problemeve kryesore	9
2.1 Mungesa e infrastrukturës dhe e mbulimit me shërbime	10
2.2 Qëndrueshmëria financiare dhe mungesa e mekanizmave të posaçëm të financimit ...	10
2.4 Mospërputhja e plotë me standardet e BE-së dhe boshllëqet në kuadrin rregulator kombëtar.....	12
2.5 Mirëkoordinim institucional dhe eliminimi i fragmentimit të përgjegjësive	12
3 Rekomandimet Kryesore	14
3.1 Advokimi për rritjen e burimeve financiare	14
3.1.1 Zbatimi i rekomandimeve për financimin e strategjisë kombëtare UK 2023–2030 ..	14
3.1.2 Propozimi për krijimin e fondeve të posaçme për infrastrukturën e UN	15
3.1.3 Partneritete Publike-Private për investime afatgjata	15
3.2 Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore.....	15
3.2.1 Zbatimi i një programi të qëndrueshëm trajnimi për shoqëritë UK	15
3.2.2 Krijimi i një rrjeti kombëtar të ekspertëve për menaxhimin e UN	16
3.3 Zhvillimi i mekanizmit të monitorimi për performancën e rrjeteve të UN dhe ITUN	17
3.4 Rregullat dhe standardet e infrastrukturës së ujit	17
4 Deklarata e politikës	18

SHKURTIME

AKUK	Agjencia Kombëtare Ujësjetllës Kanalizime
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AMBU	Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
GNIP-MUN	Grupi Ndërinstitucional i Punës për Menaxhimin e Ujërave të Ndotura
IARD	Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Zonën e Mbulimit të Lumit Danub
IFN	Instucionet Financiare Ndërkombëtare
ITUN	Impiant Trajtimi i Ujërave të Ndotura
ISHP	Instituti Shëndetit Publik
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
O&M	Operimi dhe Mirëmbajtja
RCDN	Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujësjetllës-Kanalizimeve
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
UK	Ujësjetllës Kanalizime
UN	Ujërat e Ndotura

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo letër pozicioni është përgatitur në kuadër të projektit “Shërbime të përgjegjshme ndaj nevojave specifike të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe aktiviteteve të avokimit”, që zbatohet në kuadër të projektit Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve (RCDN+) për këto shërbime.

Projekti RCDN+ synon të rrisë efektivitetin dhe efikasitetin e SHOQATAVE dhe kompanive publike dhe të qeverisjes vendore në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, duke kontribuar në ofrimin e shërbimeve më cilësore për anëtarët e tyre dhe duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të furnizimit me ujë dhe kanalizime për popullatën, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Projekti financohet bashkërisht nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga GIZ në kuadër të projektit “Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Modernizimi i Shërbimeve Bashkiake”.

Sfidat në Menaxhimin e Ujërave të Ndotura në Shqipëri

Sektori i menaxhimit të ujërave të ndotura në Shqipëri përballet me një sërë sfidash strukturore dhe funksionale:

- Infrastruktura ekzistuese është e vjetëruar dhe shpeshherë e pamjaftueshme për të përballuar nevojat aktuale;
- Kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore mungojnë, si në nivel vendor ashtu edhe në nivel kombëtar;
- Burimet financiare janë të kufizuara dhe shpërndarja e tyre nuk pasqyron domosdoshmëritë e sektorit;
- Kuadri institucional ka ndryshuar disa herë që prej vitit 2007, përmes reformave të nxitura shpesh pa analiza të plota mbi ndikimin dhe mësimet e nxjerra prej tyre;
- Mungesa e rrjeteve të kanalizimeve dhe sistemeve funksionale të trajtimit të ujërave të ndotura në më shumë se gjysmën e territorit të vendit;
- Koordinimi ndërinstucional nuk është i fortë, duke ndikuar në planifikimin dhe zbatimin e masave të përbashkëta.

Ky dokument, i iniciuar dhe koordinuar nga SHUKALB në bashkëpunim me grupin ndërinstucional të punës për menaxhimin e ujërave të ndotura, ofron një qasje të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt rezultateve, që synon përmirësimin e bashkëpunimit institucional, rritjen e efikasitetit të shërbimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët.

Shtyllat Kryesore të Rekomandimeve:

- Rritja e financimit dhe krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm për investime në sistemet e kanalizimeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), përfshirë:
 - Fonde të dedikuara kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Nxitjen e partneriteteve publike-private (PPP);
 - Plane investimesh të bazuara në prioritete reale dhe standarde të BE-së.
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe burimeve njerëzore përmes:
 - Trajnimeve të strukturuar sipas një kalendari të dakortësuar;
 - Bashkëpunimit të ngushtë e të qëndrueshëm me institucionet arsimore profesionale dhe universitare e me projekte të përbashkëta;
 - Themelimit dhe fuqizimit të një rrjeti kombëtar ekspertësh në projektim, operim dhe mirëmbajtje të ITUN-eve sipas kërkesave të kohës dhe modernizimi i tyre.
- Harmonizimi i standardeve të operimit dhe përputhja me direktivat e BE-së, duke përfshirë:
 - Përditësimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional në përputhje me Direktivën e Rishikuar për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (UWWTD 2024/3019), si dhe me aktet e tjera të legjislacionit të BE-së që lidhen me mjedisin, ujin dhe llumin;
 - Hartimin e udhëzuesve teknikë për planifikimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe me qëllim garantimin e performancës së qëndrueshme të sistemeve;
 - Hartimin dhe zbatimin e një plani të mirëmbajtjes parandaluese për pajisjet dhe infrastrukturën kritike të ITUN-eve, përfshirë një kalendar të detajuar të zbatimit dhe përgjegjësiwe përkatëse të stafit të ngarkuar me të;
 - Vëmendje të posaçme menaxhimit të ujërave të shiut, përmes mundësisht ndarjes së tyre nga sistemet e kanalizimeve dhe aplikimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë (Nature-Based Solutions), në përputhje me kërkesat e Direktives se re 2024/3019 dhe objektivat për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike;
 - Zhvillimin e një mekanizmi funksional për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e progresit në zbatimin e standardeve, si në nivel vendor ashtu edhe kombëtar, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të sektorit.

Thirrje për Veprim të Përbashkët

Ky dokument në formën e një letre pozicionimi përfaqëson një thirrje të qartë për bashkëpunim të zgjeruar ndër-institucional dhe për mbështetje të koordinuar nga të gjithë aktorët publikë, partnerët zhvillimorë, dhe institucionet arsimore profesionale dhe universitare për të ndërtuar një sektor të qëndrueshëm, të integruar dhe të përputhshëm me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të ujërave të ndotura.

1 Hyrje: Qëllimi i Letrës së Pozicionit

Dokumenti “Qëndrimi i SHUKALB: Roli i Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Mbështetje të Shëndetit Publik, Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Integritimit Evropian” paraqet një qëndrim të qartë strategjik mbi sfidat, mundësitë dhe drejtimit prioritarë në sektorin e menaxhimit të ujërave të ndotura në Shqipëri.

Ky dokument pozicionues synon të shërbejë si një bazë orientuese për nxitjen dhe ndikimin e politikave të reja, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përfundimin e investimeve të qëndrueshme në infrastrukturën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, në përputhje me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Pas një analize të qartë të problemeve ekzistuese dhe rekomandimeve konkrete për përmirësim, dokumenti synon të nxisë një dialog të strukturuar ndërmjet aktorëve institucionalë, partnerëve zhvillimorë, sektorit privat si dhe institucioneve arsimore profesionale dhe universitare. Ky bashkëpunim i gjerë është thelbësor për të adresuar boshllëqet ekzistuese dhe për të ndërtuar një sektor të fortë, funksional dhe të qëndrueshëm.

Njëkohësisht, dokumenti nënvizon rolin proaktiv të SHUKALB si një aktor kyç në promovimin e një qasjeje të integruar, që ndërthur disiplinat mjedisore, çështjet e mbrojtjes shëndetësore dhe zhvillimin institucional, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës për qytetarët dhe të përshpejtimin të procesit të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

1.1 Konteksti i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Ujërave të Ndotura në Shqipëri

Sektori i furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri përballet me sfida të shumta, përfshirë infrastrukturën e amortizuar, mungesën e pajisjeve moderne dhe kapaciteteve teknike. Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se mbulimi i popullsisë me furnizim me ujë arrin 76.4%, ndërsa mbulimi me rrjete kanalizimi është vetëm 55.7%, i mbështetur në rreth 383 sisteme në të gjithë vendin.

Këto shifra fshehin pabarazi të theksuara midis zonave urbane dhe rurale: në qytete, mbulimi me ujë arrin 91.45%, krahasuar me vetëm 56.4% në zonat rurale; ndërsa për kanalizimet, qytetet përfitojnë 83.9% mbulim, kundrejt një niveli shumë të ulët prej 17.3% në zonat rurale.

Mbulimi me Impiante të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) mbetet i kufizuar, në vetëm 15.3% të popullsisë. Aktualisht janë në funksion 10 impiante, me një kapacitet prej rreth 815,000 PE, ndërsa katër të tjera janë në ndërtim me potencial mbulimi prej 438,000 PE.

Megjithatë, disa nga impiantet ekzistuese po afrojnë kufirin e moshës 15-vjeçare, ndërkohë që jetëgjatësia e tyre është parashikuar në 20–25 vjet, duke nxjerrë në pah nevojën për investime në rehabilitim dhe modernizim.

Në kontekstin e një ekonomie në tranzicion dhe urbanizimit të përsheptuar, Shqipëria po përjeton rritje të ndjeshme të presionit mbi burimet ujore. Kjo është veçanërisht e dukshme në zonat bregdetare për shkak të zhvillimit të sektorit të turizmit, me mbi 11.7 milionë vizitorë në vitin 2024 dhe objektivin prej 12 milionësh për vitin 2025. Kjo rritje ka rënduar infrastrukturën ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, duke e bërë të domosdoshëm përmirësimin e saj për të garantuar cilësinë e ujërave larës dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Në përpjekje për të përballuar këto sfida, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë disa iniciativa, përfshirë:

- VKM Nr. 448, datë 26.07.2023 “Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023–2030”
- Akti Normativ Nr. 8, datë 28.12.2023, që përcakton standarde më të rrepta për ITUN dhe shkarkimet në ujërat larës;
- Udhëzuesi Teknik Kombëtar Nr. 01, datë 1.2.2024, i cili specifikon kërkesat teknike për impiantet që shkarkojnë në ose pranë ujërave larës;
- Krijimi i një Task Force të dedikuar (2024) për kontrollin e menaxhimit të ujërave të ndotura në zonat turistike bregdetare – një nismë e përbashkët e MIE dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- (Draft) Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Llumrave (2025–2050)
- (Draft) Plani i Zbatimit të Direktivës për Ujërat e Ndotura Urbane (DSIP 2025–2050), të përgatitura nga AKUK, në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- (Në proces) (Draft) Plani i Zbatimit të Direktivës për Ujërat e Ndotura Urbane 2024/3019/EEC 2025–2050, deri në fund të vitit 2025.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përmes Drejtorisë së Politikave të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), respektivisht si institucion i politikave dhe si institucioni teknik përgjegjës, kanë mandatin për politikën, planifikimin, monitorimin dhe koordinimin të sektorit.

Tek AKUK operon një Njësi për Monitorimin dhe Krahasimin e Performancës, që mbledh çdo muaj mbi 300 të dhëna nga të gjitha shoqëritë UK, përfshirë indikatorë të cilësisë së ujit të pijshëm dhe të impianteve të trajtimit. Nga këto të dhëna, llogariten 74 tregues të performancës. Sidoqoftë, mungesa e të dhënave të detajuara në terren për çdo impiant konkret përbën një boshllëk serioz në planifikim dhe monitorim. Ky program monitorimi duhet rishikuar dhe modernizuar që të përgjigjet edhe sfidave që parashktrohen nga BE.

Dokumentet strategjike ekzistuese mbështeten kryesisht në raporte fizibiliteti dhe plane zbatimi, por jo në një vlerësim të thelluar dhe sistematik të situatës reale në terren, gjë që e bën të vështirë krijimin e një pasqyre të qartë kombëtare mbi kapacitetet aktuale dhe nevojat prioritare.

Pavarësisht progresit, mbeten disa pikëpyetje kritike:

- A ekzistojnë të dhëna të plota, të përditësuara dhe të integruara mbi situatën aktuale të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në të gjithë vendin?
- A është realizuar një analizë kombëtare e detajuar që përfshin gjendjen e impianteve ekzistuese, kapacitetet, cilësinë e shkarkimeve dhe menaxhimin e llumrave?

Sektori i ujërave të ndotura në Shqipëri përfaqëson një fushë strategjike që kërkon vëmendje të madhe dhe veprim të koordinuar nga të gjithë aktorët – institucionet qendrore dhe vendore, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, organizatat profesionale, sektori privat, si dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim.

Mungesa e mbulimit me shërbime të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, kapacitetet e kufizuara teknike dhe menaxheriale, si dhe fragmentimi institucional e bëjnë të domosdoshme ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të përputhur me kërkesat e *acquis communautaire*.

Ne te njejtën kohe, ujërat e ndotura përfaqësojnë një burim me potencial të lartë, pasi rreth 99.9% e përbërjes së tyre është ujë dhe vetëm 0.1% përmban lëndë organike, mikroorganizma dhe komponime inorganike (Von Sperling, 2007; Aguilar et al., 2014). Kjo përbërje i jep vlerë të shtuar ujit të trajtuar nga impianti si një burim alternativ, veçanërisht për përdorim në industri dhe bujqësi, duke ndihmuar në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Ne kete kontekst, duhet të theksohet edhe domosdoshmeria për përputhje me Cluster 4: Agjenda e Gjelbër dhe Lidhja e Qëndrueshme, për të bashkërenduar edhe vizionin kombëtar me:

- Objektivin për një Evropë neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050,
- Potencialin e ekonomisë qarkulluese,
- Luftën kundër ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës,
- Promovimin e metodave të qëndrueshme të prodhimit dhe furnizimit me ushqime,
- Eksplorimin e potencialit të madh të turizmit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së natyrës dhe restaurimit të biodiversitetit.

Përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian dhe avancimi i procesit të integritimit nuk mund të arrihen pa një konsolidim të thelluar të këtij sektori jetik. Ndaj, kërkohet një angazhim i përbashkët për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, rritjen e investimeve, fuqizimin e kapaciteteve teknike dhe administrative, si dhe promovimin e zgjidhjeve inovative dhe miqësore me mjedisin.

Në këtë kontekst, nevoja për një pozicionim të qartë strategjik është thelbësore, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat ekzistuese dhe për të krijuar mundësi reale për përmirësim afatgjatë.

Roli i SHUKALB, si organizatë profesionale që përfaqëson interesat e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe promovon përmirësimin e vazhdueshëm të sektorit, është kyç për të nxitur dhe mbështetur reformat e nevojshme drejt një vizioni të përbashkët për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të ujërave të ndotura në Shqipëri.

1.2 Roli i SHUKALB në këtë sektor dhe qëllimi i dokumentit

Shoqata Ujësjellës-Kanalizime të Shqipërisë (SHUKALB) luan një rol kyç në mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të ujërave të ndotura, duke vepruar si një platformë gjithëpërfshirëse bashkëpunimi dhe përfaqësimi për shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve dhe profesionistët e fushës. SHUKALB promovon përmirësimin e shërbimeve përmes forcimit të kapaciteteve teknike dhe institucionale, zhvillimit të burimeve njerëzore, si dhe përmes nxitjes së politikave zhvillimore dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe me nevojat konkrete të kontekstit shqiptar.

Në një mjedis kaq sfidues, të karakterizuar nga boshllëqe infrastrukturore, kufizime financiare dhe fragmentim institucional, SHUKALB është angazhuar në mënyrë aktive për të nxitur reforma thelbësore dhe për të kontribuar në formësimin e një kuadri të integruar për menaxhimin e ujërave të ndotura. Ky dokument përfaqëson një përpjekje për të artikuluar pozicionimin strategjik të SHUKALB ndaj sfidave madhore të sektorit, si dhe për të ofruar masa konkrete që mund të udhëheqin drejt përmirësimeve të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Në përgjigje të këtyre sfidave, SHUKALB ka ndërmarrë iniciativën për ngritjen dhe koordinimin e një Grupi Ndërinstitucional Pune për Menaxhimin e Ujërave të Ndotura, konceptuar si një mekanizëm gjithëpërfshirës bashkëpunimi dhe avokimi zhvillimor. Ky grup përfshin përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, autoriteteve rregullatore, shoqërive UK, sektorit privat, si dhe institucioneve arsimore profesionale dhe universitare, duke sjellë bashkë një shumëllojshmëri disiplinash dhe perspektivash teknike, ekonomike e mjedisore. Në rolin e koordinatorit teknik, SHUKALB ka mundësuar formalizimin e grupit, zhvillimin e takimeve periodike dhe hartimin e planit të punës për vitin 2025, duke vendosur themelet për një mekanizëm funksional ndërinstitucional dhe ndërsektorial.

Ky dokument, i cili është produkt i diskutimeve gjate takimeve të Grupit të Punes Ndërinstitucional për Menaxhimin e Ujërave të Ndotura, synon të shërbejë si një bazë e argumentuar për dialog politik dhe vendimmarrje strategjike ndërmjet gjithë aktorëve të lartpërmendur, Ai synon të përcaktojë një drejtim të qartë për avancimin e politikave, reformave dhe praktikave në menaxhimin e ujërave të ndotura në Shqipëri, duke promovuar një vizion të përbashkët për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e shërbimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe sfidat integruese të Bashkimit Evropian.

1.3 Nevoja për një pozicionim të strukturuar mbi sfidat dhe mundësitë e sektorit

Sektori i ujërave të ndotura në Shqipëri ndodhet në një fazë kyçe të zhvillimit të tij, ku kërkohet një pozicionim strategjik i qartë dhe i koordinuar ndërinstytucional, që të udhëheqë reformat për përmbushjen e kërkesave teknike, mjedisore dhe ekonomike në përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian.

Përballë sfidave strukturore dhe operacionale – përfshirë fragmentimin institucional, kapacitetet e kufizuara administrative, mungesën e qëndrueshmërisë financiare, si dhe nevojën për përmirësim të ndjeshëm të shërbimeve – është e domosdoshme dhe përcaktimi i një qëndrimi të përbashkët orientues për të gjithë aktorëve, për të siguruar një drejtim koherent të shërbimit me kanalizime dhe Impiante trajtimi.

Ky pozicionim nuk synon vetëm evidentimin e problemeve ekzistuese, por thekson gjithashtu potencialin për përparim të qëndrueshëm nëpërmjet: mobilizimit të fondeve të reja nga instrumentet IPA dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim; konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstytucional për ndërtimin dhe përforcimin e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale; krijimit të mekanizmave funksionalë për mirëmbajtjen dhe operimin afatgjatë të sistemeve; dhe integritet të teknologjive të avancuara, përfshirë zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe digjitalizimin.

Ky orientim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e procesit të integritet evropian, ku përputhshmëria me kërkesat e Direktivës së Rishikuar për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (2024/3019) përfaqëson një kusht kyç për përparimin në Kapitullin 27 të negociatave.

Formulimi i një qasjeje të unifikuar dhe të mbështetur nga të gjithë aktorët – përfshirë autoritetet publike, institucionet rregullatore, donatorët zhvillimorë, sektorin privat dhe institucionet e arsimit profesional dhe universitar – do të kontribuojë në një qeverisje më efektive, në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve dhe shërbimeve në sektorin e ujërave të ndotura. Ky dokument synon të ofrojë pikërisht këtë kornizë të përbashkët veprimi dhe të nxisë koordinimin për arritjen e rezultateve konkrete dhe afatgjata.

2 Përmbledhje e problemeve kryesore

Sektori i ujërave të ndotura në Shqipëri përballet me sfida të ndërlidhura strukturore, teknike, institucionale dhe financiare, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në aftësinë për të ofruar shërbime efikase, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Konkluzionet e nxjerra nga konsultimet e grupi I punës dhe analizat e aktorëve përkatës të sektorit tregojnë qartë se këto probleme duhet adresuar përmes një qasjeje të integruar dhe të koordinuar shumëaktorëshe.

2.1 Mungesa e infrastrukturës dhe e mbulimit me shërbime

Zona të gjera, veçanërisht në ato rurale dhe periferitë urbane, nuk janë të mbuluara nga rrjete funksionale kanalizimesh apo impiante trajtimi të ujërave të ndotura (ITUN). Rrjetet ekzistuese janë të amortizuara, jo të ndërthurura me sistemet e trajtimit, dhe shpesh nuk përballojnë dot ngarkesat shtesë nga zhvillimi urban ose ujërat e rrebesheve të shiut. Për më tepër, shoqëritë UK nuk disponojnë burime të mjaftueshme për të vetëfinancuar projektet kapitale, duke u mbështetur thuajse tërësisht në fonde nga buxheti i shtetit apo donatorët.

2.2 Qëndrueshmëria financiare dhe mungesa e mekanizmave të posaçëm të financimit

Investimet kapitale për ndërtimin e infrastrukturës dhe burimet e nevojshme për mirëmbajtjen afatgjatë janë ende të pamjaftueshme. Të dhënat buxhetore të raportuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tregojnë një ndarje disproporcionale mes investimeve për furnizimin me ujë dhe atyre për kanalizime, me këto të fundit që mbeten në nivele të ulëta, veçanërisht në zonat rurale.

Në përgjigje të kësaj situate, Udhëzimi nr. 8, datë 11.10.2024, ka krijuar një mundësi konkrete për financim përmes Programit Buxhetor “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”. Ky instrument ofron mbështetje për investime publike kapitale që synojnë zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjeteve të kanalizimeve, ndërtimin dhe përmirësimin e ITUN-eve, si dhe fuqizimin e kapaciteteve operacionale të shoqërive UK, sipas kriterëve të përcaktuara nga AKUK.

2.3 Kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore shumë të kufizuara

Një nga barrierat strukturore më të mëdha në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve është mungesa e kapaciteteve teknike dhe e personelit të kualifikuar për operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit. Shumë Shoqëri Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve (UK) përballen me vështirësi të mëdha në rekrutimin dhe mbajtjen e specialistëve të trajnuar, çka ndikon drejtpërdrejt në performancën teknike të rrjeteve dhe impianteve, në përmbushjen e standardeve mjedisore ligjore dhe në planifikimin afatgjatë të mirëmbajtjes parandaluese.

Disa nga problematikat për s ai perket burimeve njerëzore sot përfshijnë:

- **Mungesa e stafit të mjaftueshëm:** Shumë shoqëri në UK përballen me mungesë të punonjësve në trajtimin e ujërave të ndotura dhe rrjetin e kanalizimeve, si pasoje e interesit të ulët për të punuar për shkak të pagave të ulëta, të cilat e bëjnë sektorin jo tërheqës për punonjës të rinj dhe teknikë të kualifikuar.
- **Mungesa e kapaciteteve teknike dhe profesionale:** Shumica e stafit nuk kanë kualifikimin apo aftësitë e duhura për menaxhimin e impianteve dhe operimin e

pajisjeve moderne. Po ashtu, mungojnë trajnimet e vazhdueshme dhe kurset e specializuara, veçanërisht për laboratorët dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektromekanike.

- **Plakja e sektorit:** Një pjesë e madhe e punonjësve janë afër moshës së pensionit, sidomos operatorët e kanalizimeve dhe impianteve. Mungesa e një plani për zëvendësimin e tyre dhe transferimin e njohurive rrezikon krijimin e boshllëqeve në staf.
- **Mungesë motivimi:** Puna e rëndë fizike, mungesa e mjeteve mbrojtëse, shpërblimeve dhe mundësive për avancim profesional ndikojnë negativisht në motivimin e stafit. Për më tepër, puna në kanalizime shpesh shoqërohet me stigmatizim social.
- **Mungesë e planeve për zhvillimin e kapaciteteve:** Shumë shoqëri nuk kanë një plan të dokumentuar për zhvillimin e burimeve njerëzore. Buxheti i dedikuar për trajnime është i pamjaftueshëm, duke bërë që trajnimet të jenë të rastësishme apo të mos lidhen drejtpërdrejt me nevojat konkrete të departamenteve.

Disa të dhëna statistikore indikative:

- Pjesa e stafit në kanalizime dhe ujë të ndotur zakonisht përbën 15-20% të stafit të përgjithshëm të shoqërisë.
- Në shumë shoqëri Ujësjellës Kanalizime, rreth 50% e stafit të sektorit të ujit të ndotur kanë moshën mbi 50 vjeç.
- Vetëm 5–10% e stafit kanë kualifikim të lartë ose trajnime specifike mbi trajtimin e ujërave të ndotura.

Pavarësisht ekzistencës së programeve universitare dhe profesionale në fushën e ujit dhe mjedisit, vazhdon të ekzistojë një boshllëk i konsiderueshëm në lidhje me kualifikimin e vazhdueshëm pas diplomimit. Në këtë kontekst, SHUKALB ka luajtur dhe vijon të luajë një rol kyç përmes ofrimit të moduleve të strukturuar të trajnimit dhe iniciativave për zhvillimin e një rrjeti kombëtar të ekspertëve-trajnues.

Bashkëpunimet me institucionet arsimore synojnë institucionalizimin e ndërtimit të kapaciteteve si një komponent i qëndrueshëm i sistemit të edukimit profesional dhe universitar në Shqipëri.

Bazuar në Programin e Trajnimit dhe Certifikimit të zhvilluar nga SHUKALB në bashkëpunim me USAID, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë miratoi Udhëzimin nr. 660, datë 28.09.2018, “Për krijimin dhe zbatimin e programit kombëtar të trajnimit dhe certifikimit në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, bazuar në testim”.

Në këtë kuadër, SHUKALB ka kontribuar dhe vijon të kontribuojë në nivel kombëtar për mbështetjen e realizimit të një prej Objektivave të Misionit të Strategjisë Sektoriale për

Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime në Shqipëri (2023–2030). Shumica e kurrikulave të trajnimit janë të dizajnuara për të përgatitur kandidatët për certifikim të bazuar në testim dhe për t’u ofruar operatorëve të certifikuar dhe teknikëve të fushës mundësi të vazhdueshme për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

2.4 Mospërputhja e plotë me standardet e BE-së dhe boshllëqet në kuadrin rregullator kombëtar

Përkundër progresit të bërë në përafrimin ligjor me direktivat e BE-së, sidomos me transpozimin e Direktivës 91/271/KEE për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, zbatimi i saj është në hapat e parë. Ligji nr. 29/2024 për burimet ujore përbën një hap të rëndësishëm drejt integritimit të kërkesave të kësaj direktive, përfshirë: konceptin e aglomerateve, standardet për shkarkime, trajtimin e llumit dhe planifikimin në nivel aglomerati.

Për të forcuar përafrimin me BE-në, do të miratohet një Vendim i posaçëm i Këshillit të Ministrave (VKM), në përputhje me Ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, për të mbështetur transpozimin e plotë të Direktivës 91/271/KE mbi Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (UWWTD) brenda vitit 2026. Gjithashtu, do të miratohet një VKM i posaçëm në përputhje me Ligjin nr. 29/2024 për miratimin e listës së substancave ndotëse, si dhe të vlerave kufi të shkarkimeve të ujërave të ndotura nga burime industriale, brenda vitit 2025.

Gjithashtu, bazuar në Objektivin e Misionit 6, “Përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator” të Strategjisë Kombëtare për Sektorin e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023–2030, pritet që deri në vitin 2025 të arrihet harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor kombëtar për ujërat e ndotura dhe shërbimet e trajtimit me Direktivën Evropiane 91/271/KE.

2.5 Mirëkoordinim institucional dhe eleminimi i fragmentimit të përgjegjësive

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU), Enti Rregullator i Ujit (ERRU), njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve (ShaRUK) ushtrojnë funksione të ndara por ne disa raste edhe të mbivendosura në hartimin e politikave, rregullimin teknik dhe ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, mungesa e një koordinimi të qëndrueshëm ndërmjet tyre pengon krijimin e një vizioni të përbashkët strategjik dhe ndikon negativisht në zbatimin efektiv të reformave të domosdoshme.

Në këtë kontekst, krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave ndërinstitucionalë për planifikimin, mbikëqyrjen dhe raportimin është thelbësor. Po ashtu, përfshirja aktive e aktorëve të tjerë – përfshirë sektorin privat, institucionet kërkimore, universitetet dhe

ofruesit e arsimit profesional – mbetet një domosdoshmëri për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e ujërave të ndotura.

Më poshtë paraqitet një listë e institucioneve ekzistuese që zotërojnë kompetenca në fushën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri:

- Kryeministria dhe Këshilli i Ministrave
- Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
- Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve (AKUK)
- Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
- Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU)
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE)
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) (e shtuar me Direktiven e re 2024/3019)
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)
- Shoqëritë Aksionare Rajonale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime (ShaRUK)
- Bashkitë
- Shoqata Ujësjetës Kanalizime e Shqipërisë SHUKALB

Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional përbën një parakusht thelbësor për përmbushjen e kërkesave të acquis communautaire të BE-së dhe për sigurimin e rezultateve të qëndrueshme në menaxhimin e ujërave të ndotura. Kjo nënkupton: (i) qartësimin e funksioneve dhe përgjegjësisë ligjore të secilit institucion përkatës; (ii) krijimin dhe operacionalizimin e mekanizmave efektivë të bashkëpunimit ndërsektorial; si dhe (iii) forcimin e kapaciteteve dhe rolit të aktorëve kyç në sektor, përfshirë SHUKALB, si një ndërmjetësues i rëndësishëm midis praktikës teknike dhe procesit të hartimit të politikave.

3 Rekomandimet Kryesore

Për të adresuar sfidat strukturore dhe institucionale në sektorin e menaxhimit të ujërave të ndotura, si dhe për të shfrytëzuar në mënyrë efektive mundësitë që ofron procesi i integritimit në Bashkimin Evropian, nevojitet një qasje e orientuar drejt veprimit të bashkërenduar. Kjo qasje duhet të bazohet në bashkëpunim të qëndrueshëm ndërinstytucional, forcim të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, mobilizim të burimeve të nevojshme financiare dhe teknike.

Më poshtë paraqiten rekomandimet prioritare, të strukturuar sipas tre shtyllave strategjike për ndërhyrje:

3.1 Advokimi për rritjen e burimeve financiare

3.1.1 Zbatimi i rekomandimeve për financimin e strategjisë kombëtare UK 2023–2030

Strategjia Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030 përcakton një vizion të qartë për arritjen e aksesit universal dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Një nga shtyllat kryesore të strategjisë është sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare, për të mbështetur investimet kapitale dhe operacionale në infrastrukturën e kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit, si dhe për të garantuar përputhshmërinë me Direktivën për Ujërat e Ndotura Urbane.

Strategjia përfshin një analizë të detajuar të nevojave financiare, duke përfshirë investimet kapitale (CAPEX) dhe kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (OPEX), dhe identifikon nevojën për:

- Diversifikimin e burimeve të financimit, duke përfshirë fondet buxhetore, donacionet ndërkombëtare, kreditë me kushte të favorshme dhe tarifatat nga përdoruesit.
- Rritjen graduale të mbulimit të kostove të shërbimit përmes tarifave, duke ruajtur përbalueshmërinë për konsumatorët.
- Zhvillimin e një plani të integruar veprimi me kosto të detajuara, i cili do të shërbejë si bazë për programimin buxhetor afatmesëm.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve kërkon angazhim të koordinuar ndërinstytucional midis MIE, MFE, AKUK, ERRU dhe bashkive, si dhe përfshirjen aktive të shoqërive UK dhe organizatave të sektorit si SHUKALB. Donatorët ndërkombëtarë, përfshirë BE-në dhe institucionet financiare zhvillimore, do të luajnë një rol kyç në ofrimin e asistencës teknike dhe financiare. SHUKALB mund të kontribuojë në këtë proces si partner teknik dhe përkrahës, duke promovuar pjesëmarrjen aktive të shoqërive UK dhe bashkive në planifikim dhe zbatim.

3.1.2 Propozimi për krijimin e fondeve të posaçme për infrastrukturën e UN

Për të rritur aksesin e shoqërive UK në investime kapitale për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, rekomandohet ngritja e një fondi të dedikuar, i cili do të administrohet nga AKUK brenda Programit Buxhetor 06370, në përputhje me Udhëzimin nr. 8/2024. Ky fond do të operojë përmes thirrjeve vjetore, me kritere të qarta teknike, ekonomike dhe mjedisore për përzgjedhjen e projekteve.

3.1.3 Partneritete Publike-Private për investime afatgjata

Investimet në infrastrukturën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura kërkojnë angazhime financiare afatgjata dhe kapacitete teknike të qëndrueshme. Për shkak të kufizimeve buxhetore dhe kapaciteteve të pamjaftueshme teknike dhe menaxheriale në nivel vendor, partneritetet publike-private (PPP) paraqesin një mundësi për të përshpejtuar investimet, rritur efikasitetin operativ dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Konsiderimi i PPP-ve në sektor duhet të ndjekë një qasje të kujdesshme dhe të orientuar nga parimet e transparencës, përfitueshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik.

3.2 Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore

3.2.1 Zbatimi i një programi të qëndrueshëm trajnimi për shoqëritë UK

Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të kanalizimeve lidhet ngushtë me forcimin e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale të shoqërive, veçanërisht në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Në këtë kontekst, SHUKALB sheh si domosdoshmeri zbatimin e Programit Kombëtar të Trajnimit dhe Certifikimit Bazuar në Testim (hartuar nga SHUKALB në partneritet me MIE dhe mbështetjen e aktoreve të tjera të sektorit), si një strukturë e qëndrueshme institucionale për zhvillimin e kapaciteteve të të gjitha shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në nivel kombëtar.

Zbatimi i këtij programi nënkupton:

- Module të strukturuar trajnimi për tematika teknike (operimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjeteve, menaxhimi i llumit, monitorimi i parametrave, siguria në punë) dhe fusha menaxheriale (planifikimi financiar, raportimi, shërbimi ndaj klientit).
- Klasifikim të niveleve të aftësive (bazik, ndërmjetëm, i avancuar) për t'u përshtatur me profilin e punonjësve.
- Vlerësim periodik të nevojave për trajnim, në bashkëpunim me ERRU, AKUK dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.
- Sistem certifikimi profesional për të nxitur standardizimin e kompetencave në nivel kombëtar.

SHUKALB, përmes programit të trajnimeve të saj, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e formimit praktik për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve gjatë dy dekadave të fundit. Shoqata ka përgatitur dhe testuar modulet e para trajnimit për fushën e

kanalizimeve, të hartuara në bashkëpunim me agjenci zhvillimore dhe praktikant më të mira ndërkombëtare.

Në partneritet me donatorët dhe institucionet publike, SHUKALB është në gjendje të:

- Zhvillojë dhe operojë programin e trajnimit, duke shfrytëzuar rrjetin e trajnerëve të certifikuar dhe qendrën kombëtare të trajnimeve.
- Koordinojë një rrjet për shkëmbimin e praktikave dhe eksperiencave ndërmjet shoqërive, përmes grupeve tematike dhe rrjeteve të profesionistëve.
- Pilotojë programe certifikimi në bashkëpunim me qendrat e formimit profesional dhe institucionet e arsimit të lartë teknik.

Zbatimi i një programi të tillë, me mbështetjen financiare të institucioneve kryesore buxhetore si MIE, AKUK dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, do të garantonte akses të barabartë në zhvillimin profesional për të gjitha shoqëritë, do të rrisë kapacitetet brenda sektorit dhe do të kontribuonte drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare

3.2.2 Krijimi i një rrjeti kombëtar të ekspertëve për menaxhimin e UN

Për të garantuar transferimin e njohurive dhe mbështetjen teknike për shoqëritë më të vogla, propozohet ngritja e një rrjeti kombëtar ekspertësh teknikë, i cili do të ofrojë mentorim, ndihmë për zgjidhje teknike dhe mbështetje për vlerësimin e performancës. SHUKALB mund të koordinojë këtë rrjet dhe të ofrojë platformën për shkëmbim njohurish dhe trajnime me mbështetjen financiare të institucioneve kryesore buxhetore dhe donatorëve.

Ky rrjet do të përbëhet nga profesionistë me përvojë në:

- Projektimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN).
- Menaxhimin e rrjeteve të kanalizimeve.
- Planifikimin e investimeve dhe kostove në fushën e kanalizimeve.
- Zbatimin e standardeve teknike dhe kërkesave ligjore për shkarkimet në mjedis.

SHUKALB është institucioni më i përshtatshëm për të marrë rolin e koordinuesit të këtij rrjeti, duke u mbështetur në:

- Eksperiencën e saj në zhvillimin e komuniteteve profesionale në sektor.
- Platformën ekzistuese të komunikimit me shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.
- Aftësinë për të ofruar trajnime, mbështetje logjistike dhe organizim të seminareve tematike.
- Lidhjeve dhe bashkëpunimeve afat gjata me organizata profesionale në nivel rajonal dhe botëror duke përfshirë aderimin në Shoqatën Ndërkombëtare të Kompanive Ujësjellës Kanalizime në Zonën e Mbulimit të Lumit Danub (IAWD), Shoqatës Evropiane të Ujit (EWA), Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA).

Në fazën fillestare, rrjeti mund të ngrihet mbi bazën e ekspertëve të identifikuar nga shoqëritë më të konsoliduara, nga trajnerët e certifikuar të SHUKALB dhe nga ish-punonjës të sektorit me përvojë të gjatë. Gradualisht, rrjeti mund të zgjerohet dhe formalizohet përmes bashkëpunimit me AKUK dhe institucionet arsimore dhe rregullatore.

3.3 Zhvillimi i mekanizmit të monitorimi për performancën e rrjeteve të UN dhe ITUN

Aktualisht, AKUK ka ngritur një sistem online raportimi, përmes të cilit shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve dorëzojnë periodikisht të dhëna operationale mbi rrjetet e kanalizimeve dhe funksionimin e impianteve të trajtimit. Ky sistem përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt dixhitalizimit dhe standardizimit të informacionit teknik në sektor.

Për të maksimizuar efektivitetin e këtij mekanizmi, rekomandohet ndërtimi dhe operacionalizimi i një kuadri të strukturuar kombëtar për monitorimin dhe vlerësimin e performancës. Ky kuadër duhet të përfshijë:

- Publikimin periodik të një Raporti Vjetor Kombëtar mbi Performancën e Kanalizimeve dhe ITUN-eve, me përmbledhje të të dhënave të përpunuara në mënyrë të agreguar;
- Përdorimin e indikatorëve të matshëm të performancës për vlerësimin e eficiencës teknike, cilësisë së shërbimit dhe përputhshmërisë mjedisore.

Ky raport do të shërbejë si mjet i rëndësishëm për:

- Institucionet përgjegjëse në nivel qendror për planifikim strategjik dhe rregullim sektorial;
- Donatorët ndërkombëtarë për orientim më të saktë të mbështetjes teknike dhe financiare;
- Shoqëritë UK për vetëvlerësim, krahasim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës.

3.4 Rregullat dhe standardet e infrastrukturës së ujit

Rishikim ose hartimi i një rregulloreje të re në lidhje me standardet dhe rregullat e projektimit për FU, Kanalizimet dhe ITUN. Këto standarde të tilla si ato të zhvilluara nga DVGW, që mbulojnë një gamë të gjërë aspektesh, duke përfshirë rregullat teknike dhe çertifikimin.

- Rregullat teknike: Këto udhëzime mbulojnë aspekte të ndryshme të infrastrukturës së ujit, duke përfshirë projektimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe operimin.
- Çertifikimi: Standardet lehtësojnë çertifikimin e produkteve, kompanive dhe individëve të përfshirë në industrinë dhe sektorin e ujit, duke siguruar që ato të përmbushin nivelet e kërkuara të cilësisë dhe sigurisë.

Roli i SHUKALB në këtë proces mund të jetë thelbësor, përmes:

- Ofrimit të asistencës teknike për përzgjedhjen dhe formulimin e indikatorëve të monitorimit;
- Organizimit të trajnimeve për stafin teknik të shoqërive UK mbi grumbullimin dhe raportimin e të dhënave sipas kërkesave të sistemit;
- Promovimit të praktikave më të mira të menaxhimit dhe monitorimit nga vendet e BE-së.

Ky mekanizëm do të jetë një element kyç për të kaluar drejt një modeli proaktiv, të bazuar në të dhëna, duke siguruar transparencë, efikasitet operativ dhe përputhje me standardet e BE-së në sektorin e ujërave të ndotura.

4 Deklarata e politikës

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), si organizatë profesionale e angazhuar për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit në vend, deklaron publikisht përkushtimin e saj për të mbështetur dhe përfaqësuar transformimin e sektorit të ujërave të ndotura në përputhje me standardet evropiane, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe interesin publik afatgjatë.

Ujërat e ndotura nuk përbëjnë vetëm një sfidë infrastrukturore, por edhe një mundësi për zhvillim ekonomik, rikuperim të burimeve dhe rritje të qëndrueshmërisë mjedisore. Kështu, duke u bazuar në analizën e sfidave dhe mundësive në këtë sektor,

SHUKALB:

1. Promovon një vizion proaktiv dhe zhvillimor për menaxhimin e ujërave të ndotura

SHUKALB e konsideron trajtimin e ujërave të ndotura si një çështje strategjike kombëtare që lidhet ngushtë me:

- Mbrojtjen e shëndetit publik;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe ekosistemeve ujore;
- Zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale;
- Përbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE (Kapitulli 27 – Mjedisi).

2. Mbron interesat dhe fuqizon kapacitetet e operatorëve të shërbimit

SHUKALB është ura lidhëse mes shoqërive UK, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe donatorëve, duke synuar:

- Rritjen e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale për menaxhimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe ITUN-eve;
- Sigurimin e trajnimeve të specializuara për stafet operative dhe inxhinierike;
- Lehtësimin e dialogut mbi praktikatat më të mira dhe sfidat në terren.

3. Angazhohet për reforma të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse

SHUKALB mbështet dhe nxit:

- Zbatimin e strategjisë kombëtare për UK 2023–2030, me theks në rritjen e financimit për ujërat e ndotura;
- Harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me kërkesat e Direktivës 91/271/CEE dhe Direktivës Kuadër për Ujin;
- Vendosjen e indikatorëve të standardizuar për monitorimin e performancës së rrjeteve dhe impianteve.
- Përkrah bashkëpunimin ndërinstitucional dhe veprimin e koordinuar.

4. Në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, SHUKALB:

- Mbështet forcimin e rolit të AKUK, ERRU, AMBU, ISHP dhe AKM në fushën e ujërave të ndotura;
- Promovon funksionimin efektiv të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Menaxhimin e Ujërave të Ndotura si platformë për planifikim, harmonizim dhe zbatim të reformave;
- Inkurajon përfshirjen aktive të bashkive dhe shoqërive UK në proceset vendimmarrëse.

5. Promovon transparencën, inovacionin dhe ekonominë qarkulluese

SHUKALB angazhohet për:

- Përdorimin e teknologjive të reja dhe modeleve efikase për operim dhe mirëmbajtje të ITUN-eve;
- Shfrytëzimin e potencialit për rikuperimin e burimeve (energji nga llumi, përdorimi i ujit të trajtuar) në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese;
- Zhvillimin e një sistemi të hapur dhe të harmonizuar për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave teknike dhe mjedisore.

SHUKALB beson se bashkëpunimi, planifikimi afatgjatë dhe investimi i qëndrueshëm janë çelësi për ndërtimin e një sektori funksional, të integruar dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes në menaxhimin e ujërave të ndotura.

Menaxhimi i ujërave të ndotura përbën një test të qartë për seriozitetin me të cilin Shqipëria i qaset zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe integritit në Bashkimin Evropian.

Ky dokument është një angazhim i përbashkët për veprim, për ta kthyer një sfidë shumë komplekse në një mundësi transformuese. Ai fton të gjithë aktorët – publikë, privatë, vendorë e ndërkombëtarë – të kontribuojnë me përgjegjësi, profesionalizëm dhe vizion.

SHUKALB BESON SE PËRMES BASHKËPUNIMIT, PROFESIONALIZMIT DHE INVESTIMIT TË QËNDRUESHËM, SHQIPËRIA MUND TË NDËRTOJË NJË SEKTOR TË UJËRAVE TË NDOTURA QË JO VETËM PËRMBUSH DETYRIMET E INTEGRIMIT EVROPIAN, POR EDHE SHËRMBEN SI THEMEL PËR NJË TË ARDHME MË TË PASTËR, MË TË SIGURT DHE MË TË DREJTË PËR TË GJITHË.

REFERENCAT KRYESORE

- Ligji Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 29, datë 7.3.2024, “Për burimet ujore”
- VKM Nr.177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Kodi i Furnizimit me ujë dhe Kanalizimeve”
- VKM nr. 83, datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve” (përfshihen edhe impiantet)
- VKM nr. 302, datë 1.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin (nga 58 në 15 Kompani Ujësullës-Shkarkimi) të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura."
- VKM nr. 617, datë 1.11.2023 për krijimin dhe organizimin e Agjencisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.
- VKM nr. 448, datë 26.7.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023–2030."
- Kuvendi i Shqipërisë nxori Aktin Normativ Nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për ujërat e ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse."
- Udhëzim i Përbashkët MTE-MIE Nr. 1, datë 1.2.2024 “Për miratimin e rregullores teknike mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajtuara pranë ose në ujëra larëse”
- Udhëzime Kombëtare Nr. 8, datë 11.10.2024 “Për miratimin e metodologjisë, kriterëve dhe procedurave për vlerësimin dhe prioritizimin e fondeve buxhetore për investimet publike në ofruesit e shërbimeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.
- (Draft) Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës (DSIP) për ITUN (91/271/EEC), 2023–2050
- (Draft) Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Llumrave, 2023-2050
- Draft VKM 2025:”Për trajtimin e ujërave të ndotur urbane”.
- Draft VKM 2025: “Për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotje